



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

АПЕЛАЦИОНЕН СУД ГОСТИВАР
GJYKATA E APELIT GOSTIVAR

Ул. Живко Брајковски бр.1, 1230 Гостивар / тел: 042-221-544 / info@asgostivar.mk
Rr. Zhivko Brajkovski nr.1, 1230 Gostivar / tel: 042-221-544 / info@asgostivar.mk

SU.nr.343/20
31.12.2020
GOSTIVAR

Në bazë të nenit 112 të Rregullores së Gjykatës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 66/2013), pas mendimit të marrë më parë nga seancat e gjykatësve të Gjykatës së Apelit Gostivar, Kryetari i Gjykatës së Apelit Gostivar, Gjykatësi Bekim Mehmedi, sot më datë 31.12.2020, përcakton si më poshtë:

RAPORTI VJETOR

Për punën e gjykatësve dhe të punësuarve në
Gjykatën e Apelit Gostivar për vitin 2021

Gjykata e Apelit Gostivar, funksionin gjyqësor e kryen me 11 gjykatës, përfshirë edhe Kryetarin gjykatës.

Në pajtim me Vendimin e Këshillit Gjyqësor të RMV-së në këtë gjykatë është vërtetuar që funksionin gjyqësor ta kryejnë 16 gjykatës përfshirë edhe kryetarin e gjykatës.

Gjykata e Apelit në Gostivar kryen funksionin e saj gjyqësor me 32 nëpunës gjyqësorë, si vijon: - 1 / **një** / udhëheqës i nëpunësve, 1 / **një** / udhëheqës i sektorit të informatikës, 7 / **shtatë** / këshilltarë, 1 / **një** / këshilltarë informatik, 2 / **dy** / bashkëpunëtorë gjyqësor, 5 / **pesë** / bashkëpunëtor të ri, 2 / **dy** / bashkëpunëtor - përkthyes, 1 / **një** / bashkëpunëtor i ri – ekonomist, 1 / **një** / kontabilist, 1 / **një** / referent i pavarur gjyqësor në seksionin e informatikës, 1 / **një** / nëpunës gjyqësor i lartë në sekretarinë e seksionit penal, 1 / **një** / nëpunës i ri në sekretarinë e seksionit civil, 1 / **një** / referent i lartë gjyqësor në arhivën e gjykatës, 5 / **pesë** / referent gjyqësorë – daktilograf.

Gjykata e Apelit Gostivar, në pajtim me Ligjin për Marrëdhënie me Punën ka punësuar 1 /**një**/ shofer dhe 1 / **një** / pastruese.

Sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Punëve në këtë gjykatë, është përcaktuar që shërbimi gjyqësor të numërojë 110 bashkëpunëtorë gjyqësorë dhe 10 staf teknik, si dhe 8 kryerës në policinë gjyqësore.

Sipas Aktit për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Punëve, 33 vende të punës janë plotësuar në administratën gjyqësore, një vend pune bashkëpunëtor i ri është në pushim deri më 11.02.2022, në policinë gjyqësore nuk është plotësuar asnjë vend pune.

Në këtë gjykatë nuk janë plotësuar gjithsej 95 vende pune.

Për shkak të zgjidhjes në kohë dhe efikase të lëndëve dhe kryerjes efikase dhe efektive të funksionit të gjykatës, duke marrë parasysh periudhën aktuale të funksionimit të gjykatës, Kryetari i Gjykatës propozon programin e mëposhtëm të punës të Gjykatës së Apelit për vitin 2021:

KRYETARI I GJYKATËS

I.

Në pajtim me Ligjin për Gjykatat, Kryetari i Gjykatës përfaqëson gjykatën, organizon dhe ndërmerr masa për kryerjen e punës në gjykatë, duke siguruar kështu zbatimin e Rregullores së Gjykatës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/2013).

Kryetari i Gjykatës në Këshillin Penal, në procedurë ankese të shkallës së dytë, procedon:

– me regjistrin "**KSZH**", "**KR**", dhe "**R**"

Vendos në lëndët e regjistruara në administratën gjyqësore, edhe atë për:

- lëndë në regjistrin - "**RGJ**";

- lëndë të besueshme në regjistrin - "**RGJ - DOV**";

- lëndë rreptësisht të besueshme në regjistrin - "**RGJ – STR - DOV**";

- evidentimin e parashtresave, ankesave në regjistrin - "**UPP**";

Kryetari thërret seancat e gjykatësve të paktën një herë në muaj, në të cilat seanca shqyrtohen raportet mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe një vjeçare për punën e gjykatës, numrin e lëndëve të zgjidhura - përmbushja e normës së orientimit, tejkalimi i fluksit të lëndëve, zgjidhja e lëndëve të vjetra të pazgjidhura, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me punën e gjykatës dhe punën e gjykatave themelore në rrethinën e kësaj gjykate.

Merr masa të përshtatshme, në përputhje me Ligjin për Gjykatat dhe Rregulloren e Gjykatës, për të zgjidhur dhe gjykuar çështjet brenda një kohe të arsyeshme, ndërmerr veprime edhe në lidhje me të dhënat kur është pranuar lënda, a është zgjidhur brenda afatit të parashikuar nga ligji procedural dhe afati kohor në përgatitjen e vendimeve, pra aktgjykimet, kryen edhe detyra të tjera të parashikuara në Ligjin e Gjykatave dhe Rregulloren e Gjykatës dhe

me kërkesë të institucioneve të larta gjyqësore, përgatit raporte dhe informacione të tjera për punën e gjykatës.

Gjykatësi Vellko Strashevski emërohet Zëvendës Kryetar i Gjykatës së Apelit në Gostivar.

Përveç punës së rregullt gjyqësore, Nënkyetari i Gjykatës, në mungesë të Kryetarit të Gjykatës ose pengesës së tij, kryen plotësisht funksionin e Kryetarit të Gjykatës.

ADMINISTRATORI GJYQËSOR

II.

Në bazë të nenit 16 të Ligjit për Administratë Gjyqësor, Administratori gjyqësor i Gjykatës së Apelit në Gostivar administron me Administratën Gjyqësore të Gjykatës, është përgjegjës për realizimin dhe kryerjen e punëve teknike profesionale dhe administrative në gjykatë, bashkëpunon me Kryetarin e gjykatës në kryerjen e punëve të administratës gjyqësore dhe në zbatimin e Rregullores së Punës të Gjykatës, detyrat dhe obligimet e parashikuara në Ligjin për Administrimin e Lëvizjes së lëndëve në gjykatë, detyrat dhe obligimet e parashikuara në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në gjykatë, kryen edhe detyra tjera dhe detyra të punës të besuara nga Kryetari i gjykatës.

Vendi i punës Administrator Gjyqësor është i zbrazët për shkak të daljes në pension të administratorit gjyqësor, ndërsa deri në zgjedhjen e administratorit të ri përcaktohen që punët të kryhen nga udhëheqësi i nëpunësve Pëllumbesha Seferi dhe bashkëpunëtori Sedulla Memedi.

SEKSIONE NË GJYKATË

III.

Në Gjykatën e Apelit në Gostivar, në seksionin penal dhe civil, në procedurën e shkallës së dytë të ankesave, lëndët sipas AKMIS sistemit regjistrohen nën regjistrimet e mëposhtme – me shenjë, edhe atë:

- lëndë penale të shkallës së dytë – në regjistër "KZH",
- lëndë penale të shkallës së dytë në procedurë kundër të miturve – në regjistrin "KZHM"
- këshill penal i shkallës së dytë – në regjistër "KSZH" ;
- lëndë për kundërvajtje të shkallës së dytë – në regjistër "PRKZH"
- lëndë të ndryshme penale të shkallës së dytë – në regjistrin "KR"
- lëndë civile të shkallës së dytë – në regjistrin "GZH"
- lëndë të shkallës së dytë për konteste të tregtisë në regjistër "TSZH"
- lëndë të shkallës së dytë, konteste të marrëdhënieve të punës – në regjistër "ROZH"
- regjistri për lëndë të ndryshme civile – në regjistrin "R"

Gjykatësit në Seksionin Penal janë caktuar të punojnë dhe të veprojnë sipas këshillave të mëposhtme:

- këshilli **penal** në procedurë me ankesë në shkallën e dytë vepron sipas lëndëve për përsëritje të procedurës penale të evidentuara në sistemin AKCMIS, të regjistruar në regjistrin "KSZH";

- këshilli **i parë** penal në procedurë me ankesë në shkallën e dytë vepron sipas lëndëve të regjistruara në sistemin AKCMIS, të regjistruar në regjistrin "KZH" dhe "PRKZH";

- këshilli **i dytë** penal në procedurë me ankesë në shkallën e dytë vepron sipas lëndëve të evidentuara në sistemin AKCMIS, të regjistruar në regjistrin "KZH" dhe "PRKZH";

- këshilli **i tretë** penal në procedurë me ankesë në shkallën e dytë vepron sipas lëndëve të drejtave të miturve të evidentuara në sistemin AKCMIS, të regjistruar në regjistrin "KZHM";

- këshilli **i katërt** penal në procedurë me ankesë në shkallën e dytë vepron sipas lëndëve të regjistruara në sistemin AKCMIS, të regjistruar në regjistrin "KSZH" "KR" dhe "R";

- këshilli **penal** i përbërë nga pesë gjykatës në procedurë me ankesë në shkallën e dytë vepron sipas lëndëve të evidentuara në sistemin AKCMIS, të regjistruar në regjistrin "KZH".

Gjyqtarët në Seksionin Civil caktohen të punojnë dhe të veprojnë sipas këshillave të mëposhtme:

- këshilli **i parë** civil në procedurë me ankesë në shkallën e dytë vepron sipas lëndëve të evidentuara në sistemin AKMIS, të regjistruar në regjistrin "GZH";

- këshilli **i dytë** civil në procedurë me ankesë në shkallën e dytë vepron sipas lëndëve të evidentuara në sistemin AKMIS, të regjistruar në regjistrin "GZH";

- këshilli **i tretë** civil në procedurë me ankesë në shkallën e dytë vepron sipas lëndëve tregtare dhe konteste të punës të regjistruara në sistemin AKMIS, të regjistruar në regjistrin "TSZH" dhe "ROZH";

- këshilli **civil** në procedurë me ankesë në shkallën e dytë vepron sipas lëndëve për kompensim të dëmit, në përputhshmëri me Ligji për Përgjegjësinë Civile për Fyerje dhe Shpifje të evidentuara në sistemin AKMIS, të regjistruar në regjistrin "GZH";

- këshilli **civil** në procedurë me ankesë në shkallën e dytë vepron sipas lëndëve të evidentuara për falimentim të regjistruara në sistemin AKMIS, të regjistruar në regjistrin "TSZH".

Sipas nenit 12 të Ligjit për Gjykatat në Gjykatën e Apelit Gostivar, në lidhje me nenin 66 të Rregullores së Gjykatës janë formuar seksionet e mëposhtme:

- **Seksioni Penal me këshilla të specializuara;**
- **Seksioni Civil, me këshilla të specializuara;**
- **Seksioni i praktikës gjyqësore dhe evidencës;**
- **Seksioni i shërbimeve profesionale;**
- **Seksioni i Informatikës;**

- Seksioni i marrëdhënieve me publikun;
- Njësia për punën materiale dhe financiare; dhe
- Njësia për burimeve njerëzore.

I. SEKSIONI PENAL

Në Seksionin penal zgjidhen lëndët të regjistruara sipas sistemit AKMIS në:

- regjistrin "KZH", lëndë penale të shkallës së dytë;
- regjistrin "KZHM", lëndë penale të shkallës së dytë në procedurë për të mitur;
- regjistrin "KSZH", lëndë të shkallës së dytë në Këshillin Penal;
- regjistrin "KR", lëndë penale të shkallës së dytë të ndryshme; dhe në
- regjistrin "PRKZH", lëndë për kundërvajtje të shkallës së dytë.

Gjykatësi Abdulbari Ramadani emërohet Kryetar i Seksionit Penal.

Kryetari i Seksionit Penal përgatit një program dhe një raport vjetor për punën e seksionit, pasi seksioni ta miratojë atë, do t'i komunikohet Kryetarit të gjykatës,

1. KËSHILLI PENAL

Këshilli penal është i përbërë nga këta gjykatës:

1. Bekim Mehmedi, Kryetar i gjykatës, Kryetar i këshillit;
2. Shefajet Hajdari, gjykatës, anëtarë i këshillit;
3. Gjerasim Gjersaimovski, gjykatës anëtarë i këshillit.

Zëvendës i kryetarit të Këshillit Penal caktohet gjykatësi Shefajet Hajdari i cili është anëtarë i parë i këshillit.

Zëvendës i anëtarit të parë caktohet gjykatësi Abdulbari Ramadani, ndërsa zëvendës i anëtarit të dytë të Këshillit caktohet gjykatësi Velko Strashevski.

Për anëtarët e Këshillit Penal në procedurë për përsëritjen e procedurës penale në të cilën është marrë vendimi i Gjykatës së Apelit Gostivar nga një trup gjykues me pesë gjykatës, Kryetari i këshillit dhe anëtarët e tij emërohen me vendim të Kryetarit të Gjykatës, dhe pas shpërndarjes automatike të këtyre lëndëve tek gjykatësit e seksionit civil, kjo pasi që të përcaktohet që në lëndët e njëjta nuk mund askush nga gjykatësit të seksionit penal të veprojë.

Gjyqtarët e seksionit civil në këtë këshill për lëndët që regjistrohen në Gjykatën e Apelit në Gostivar me ankesë me të cilin është vendimi i shkallës së parë, me kërkesë për përsëritje të procedurës penale, do të veprojnë me rotacion në mënyrë që secili prej gjyqtarëve të marrë pjesë proporcionalisht në punën e këtij këshilli.

Në seksionin penal formohen këshillet si vijon:

A. Këshilli i parë i përbërë nga gjykatësit:

1. Abdulbari Ramadani, gjykatës, Kryetar i këshillit;

2. Shefajet Hajdari, gjykatës, anëtar i këshillit;
3. _____, gjykatës, anëtar i këshillit.

Anëtari i tretë i Këshillit të Parë Penal me tre anëtarë emërohet me rotacion, në mënyrë që çdo proces gjyqësor në Këshillin e Parë penal me tre anëtarë të marrë pjesë nga një prej anëtarëve të këshillit të Dytë të këshillit penal.

B. Këshilli i dytë penal përbëhen nga këta gjykatës:

1. Gjasim Gjasimovski, gjykatës, Kryetar i këshillit;
2. _____, gjykatës, anëtar i këshillit;
3. _____, gjykatës, anëtar i këshillit.

Anëtari i dytë dhe i tretë i Këshillit të Dytë të Këshillit Penal emërohet me rotacion, në mënyrë që çdo proces gjyqësor në Këshillin Penal të tretë anëtarëve të marrë pjesë nga një prej anëtarëve të Këshillit të parë penal me tre anëtarë.

C. Këshilli penal për të mitur i përbërë nga gjykatësit:

1. Gjasim Gjasimovski, gjykatës, kryetar i këshillit;
2. Abdulbari Ramadani, gjykatës, anëtar i këshillit;
3. Shefajet Hajdari, gjykatës, anëtar i këshillit;

D. Në Këshillin penal prej pesë anëtarëve veprojnë këta gjykatës:

1. Shefajet Hajdari, gjykatës, kryetar i këshillit;
2. Abdulbari Ramadani, gjykatës, anëtar i këshillit;
3. Gjasim Gjasimovski, gjykatës, anëtar i këshillit;
4. _____, gjykatës, anëtar i këshillit;
5. _____, gjykatës, anëtar i këshillit.

Anëtari i katërt dhe i pestë i këshillit penal prej pesë anëtarësh emërohet me vendim të kryetarit të gjyqit, nga gjykatësit e seksionit civil.

Në rast se Kryetari i Këshillit Penal prej pesë anëtarësh nuk është i lejuar të veprojë në punën e këshillit, në vend të tij do të veprojë gjykatësi Gjasim Gjasimovski, dhe në vend të tij si anëtar i tretë i këtij Këshilli do të veprojë gjykatësi i cili do të përcaktohet me vendim të kryetarit.

Në Seksionin Penal, në procedurë ankese të shkallës së dytë, gjykatësit e caktuar për të proceduar dhe gjykuar në lëndët penale janë të detyruar të veprojnë dhe gjykojnë edhe lëndë për kundërvajtje.

Në Këshillin penal caktohet bashkëpunëtor gjyqësor:

1. Pëllumbesha Seferi;

Në Këshillin e parë penal me tre anëtarë janë të caktuar këta bashkëpunëtor gjyqësor:

1. Vesna Iliq;
2. Miliat Jashari.
3. Iljaz Ademi.

Në Këshillin e dytë penal me tre anëtarë janë të caktuar këta bashkëpunëtor gjyqësor:

1. Mjaftime Neziri;
2. Driton Osmani.

Në Këshillin penal për delikuent të mitur është caktuar bashkëpunëtor gjyqësor:

1. Vesna Iliq

Në Këshillin penal me pesë gjykatës për procesmbajtës caktohet bashkëpunëtor:

Të gjithë nëpunësit gjyqësorë të cilët janë të përcaktuar në seksionin penal si dhe daktilografët.

Në Këshillin penal me tre anëtarë për përsëritje të procedurës penale për procesmbajtës është caktuar bashkëpunëtor gjyqësor si vijon:

Të gjithë nëpunësit gjyqësorë të cilët janë të përcaktuar në seksionin penal.

II. SEKSIONI CIVIL

Në seksionin civil janë formuar seksionet e mëposhtme:

- Seksioni civil;
- Seksioni për praktikë gjyqësore.

Në seksionin civil zgjidhen lëndët në:

- regjistrin "GZH", lëndë civile të shkallës së dytë;
- regjistrin "TSZH", konteste tregtare të shkallës së dytë;
- regjistrin "ROZH", konteste të punës të shkallës së dytë; dhe në
- regjistrin "R", lëndë civile të ndryshme të shkallës së dytë.

Gjykatësi Vellko Strashovski emërohet Kryetar i Seksionit Civil.

Kryetari i Seksionit civil përgatit një program dhe një raport vjetor për punën e seksionit, pasi seksioni ta miratojë atë, do t'i komunikohet Kryetarit të gjykatës,

Në Seksionin Civil formohen këshillet e mëposhtme:

A. Këshilli i parë civil i përbërë nga gjykatësit:

1. Vellko Strashovski, gjykatës, Kryetar i këshillit;
2. Ali Aliu, gjykatës, anëtar i këshillit;
3. _____, gjykatës, anëtar i këshillit.

Anëtari i tretë i këshillit të parë prej 3 persona në seksionin civil do të përcaktohet pas kërkesës së kryetarit të këshillit, me vendim të kryetarit të gjykatës.

B. Këshilli i dytë civil i përbërë nga gjykatësit:

1. Afrim Jakupi, Kryetar i këshillit;
2. Zllakto Angjellkoski, gjykatës, anëtar i këshillit;
3. _____, gjykatës, anëtar i këshillit.

Anëtari i tretë i këshillit të dytë prej 3 persona në seksionin civil do të përcaktohet pas kërkesës së kryetarit të këshillit, me vendim të kryetarit të gjykatës.

C. Këshilli i tretë civil për konteste tregtare dhe të punës përbëhet nga këta gjykatës:

1. Rafis Idri, Kryetar i këshillit;
2. Liljana Ickova, anëtar i këshillit;
3. Izet Ismaili, anëtar i këshillit.

D. Këshilli i cili vepron me lëndët për kompensim të dëmit, në pajtueshmëri me Ligjin për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje të evidentuara në sistemin AKMIS, të përbërë prej gjykatësve:

1. Liljana Ickova, gjykatës Kryetar i këshillit;
2. Vellko Strashevski, gjykatës, anëtar i këshillit;
3. Afrim Jakupi, gjykatës, anëtar i këshillit;

E. Këshilli i cili do të veproj me lëndët në falimentim është i përbërë nga gjykatësit:

1. Izet Ismaili, Kryetar i këshillit;
2. Liljana Ickova, anëtar i këshillit;
3. Rafis Idri, anëtar i këshillit.

Në këshillin e parë civil janë caktuar këta bashkëpunëtor gjyqësor:

1. Leonora Jakupi,
2. Argjent Jakupi,
3. Vjosa Ajdari

Në këshillin e dytë civil janë caktuar këta bashkëpunëtor gjyqësor:

1. Sasho Nikollooski;
2. _____,
3. _____.

Në këshillin e tretë civil për konteste tregtare dhe të punës janë caktuar këta bashkëpunëtor gjyqësor:

1. Aleksandar Duroski;
2. Arjeta Iljazi;
3. Nagip Bajrami.

Në Këshillin i cili vepron me lëndët për kompensim të dëmit, në pajtueshmëri me Ligjin për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje të evidentuara në sistemin AKMIS, është përcaktuar bashkëpunëtor gjyqësor:

1. Leonora Jakupi

Në këshillin i cili do të veproj me lëndët në falimentim caktohet bashkëpunëtor gjyqësor:

1. Aleksandar Duroski

III. SEKSIONI PËR PRAKTIKË GJYQËSORE

Për kryetar dhe zëvendës të kryetarit në seksionin për praktikë gjyqësore caktohen gjykatësit:

1. Shefajet Hajdari, gjykatës, kryetar i seksionit;
2. Vellko Strashevski, gjykatës, zëvendës i kryetarit të seksionit;
3. Abdulbari Ramadani, gjykatës, zëvendës i kryetarit të seksionit.

Seksioni i Praktikës Gjyqësore koordinon punën e të gjitha seksioneve gjyqësore në gjykatë për të kryer detyra në lidhje me regjistrimin dhe studimin e praktikës gjyqësore.

Seksioni i Praktikës Gjyqësore, në përputhje me Rregulloren e Gjykatës, është i detyruar të sjellë një plan për monitorimin e praktikës gjyqësore. Kryetarët e të gjitha seksioneve në gjykatë janë të detyruar t'i paraqesin mendimet dhe konkluzionet juridike kryetarit të këtij seksioni. Kryetari i këtij seksioni përcakton mënyrën në të cilën seksioni regjistron mendimet juridike të miratuara në seancën e seksionit. Kryetari i seksionit përcakton mënyrën e regjistrimit dhe shpalljen e praktikës gjyqësore.

Kryetari i Seksionit harton një program dhe një raport vjetor për punën e seksionit, pasi seksioni ta miratojë atë, do t'i komunikohet Kryetarit të gjykatës,

Në seksionin për praktikë gjyqësore caktohen këta bashkëpunëtor gjyqësor:

1. Pollumbesha Seferi,
2. Argjent Jakupi.

SEANCAT E KËSHILLIT

IV.

Seancat e këshillit regjistrohen në gjykatë në kohën e përcaktuar nga kryetari i këshillit, me qëllim që të shfrytëzohet sa më racional koha e punës dhe të arrihet efikasitet dhe shpejtësi në punën e gjykatës. Në rast se një anëtar i këshillit nuk është i lejuar të veprojë, Kryetari i

Gjykatës ose zëvendësi i tij përcakton me vendim një anëtar shtesë të këshillit, duke marrë parasysh ngarkesën e barabartë të gjykatësve.

Duke pasur parasysh që gjykata ka dhe përdor vetëm një sallë gjyqi, seancat publike të këshillave të Seksionit Penal do të caktohen nga kryetari i këshillit përkatës në ditët e përcaktuara për seancën e këshillit, në koordinim me kryetarët e këshillave që mbajnë seancat dhe të njëjtat do t'i raportohen sekretarit teknik të Kryetarit të gjykatës.

Këshillat Penale seancat jopublike i zhvillojnë të mërkurën dhe të enjten, ndërsa seancat publike dhe seancat e Këshillit prej pesë gjykatësve mbahen të martën, sipas nevojës, në varësi të urgjencës së lëndës dhe në ditë tjetër. Seancë në shkallën e dytë apo seancë publike përcakton kryetari i këshillit. Seancat e këshillave do të mbahen në sallën e gjykatës.

Gjykatësi për të mitur përcakton ditën dhe orën për mbajtjen e seancave të lëndëve penale ndaj të miturve.

Seancat publike në këshill prej pesë gjykatësve paraqiten tek sekretari teknik i kryetarit të gjykatës. Pasi që gjykata ka dhe përdor vetëm një sallë gjyqi, seancat e Këshillave të Seksionit Civil do t'i caktoj kryetari i këshillit përkatës në ditët e caktuara për seancën e këshillit në koordinim me kryetarët e këshillave që në ditën e njëjtë ditë mbajnë seanca dhe të njëjtat paraqiten tek sekretari teknik i Kryetarit të gjykatës.

Këshillat civil seancat jopublike i mbajnë të martën dhe të premten, ndërsa seancat publike i zhvillojnë të mërkurën. Për seancat e këshillave në sistemin AKMIS regjistrohen këto të dhëna:

- përbërja e këshillit;
- numri i lëndës – lloji i vendimit;
- data e mbajtjes të seancës së këshillit, dhe
- veprime tjera të parapara në dispozitat të ligjeve procedurale në lidhje me këshillimin dhe votimin e lëndëve (të tilla si ndarja e mendimeve nga një anëtar i këshillit, pjesëmarrja e palëve, etj).

Këshillimi dhe votimi në trajtimin e lëndëve është jopublike dhe në të marrin pjesë vetëm anëtarët e këshillit dhe procesmbajtësi.

Pasi që vendimet merren në seanca jopublike, ato nuk mund të komunikohen nga anëtarët e këshillit, stafi profesional dhe personeli tjetër gjyqësor dhe administrativ-teknik derisa lënda t'i dërgohet gjykatës themelore përkatëse.

Masat më të rënda disiplinore do të merren në përputhje me Ligjin dhe Rregulloret ndaj një zyrtari për të cilin në procedurën e duhur do të informoj për një vendim para se lënda do t'i dërgohet gjykatës përkatëse të shkallës së parë.

Në librat e tjerë të veçanta do të regjistrohen zgjidhje të reja juridike karakteristike për çështje të caktuara juridike me të cilat do t'i informohet këshillat e tjerë të njëjtës fushë, dhe nëse është e nevojshme, çështjet juridike do të inicohen nga seksioni përkatës, do të vërehet zbatimi i gabuar i ligjit procedural dhe material nga gjykatat e shkallës së parë që janë karakteristike për vizitat e punës në gjykatat e shkallës së parë, në veçanti arsyet e vonimit të procedurave në lëndët e gjykatës të shkallës së parë si dhe çështjet e tjera të rëndësishme për barazimin e juridiksionit gjyqësor dhe për të promovuar punën dhe funksionimin e gjykatave.

Gjykatësve nuk u lejohej të shpjegojnë ndonjë parregullsi në veprimet gjyqësore, vendimet si dhe deklaratat në lidhje me rezultatin përfundimtar të mosmarrëveshjes, dhe gjykatësit palëve nuk mund të japin ndihmë juridike dhe mendim për ndonjë mosmarrëveshje eventuale si në të ardhmen do të përjashtojnë kërkesën për përjashtim nga gjykatësit në bazë të asaj që palës caktuar i është dhënë këshilla juridike dhe të ngjashme.

Lëndët e anuluar nga dy seksionet që janë rikthyer në punë pas një procedure ankese para kësaj gjykate, si dhe lëndët e kthyer në mënyrë administrative në gjykatat e shkallës së parë pas kthimit të tyre në Gjykatën e Apelit Gostivar, do të punohen nga të njëjtët gjykatës që ishin vendosur më parë para pezullimit dhe para kthimit administrativ të lëndëve, përveç nëse ata gjykatës që trajtojnë ato lëndë, me një orar të ri pune, nuk transferohen në këshillat e tjerë, si dhe lëndët që përsëri vijnë me ankesë dhe i kanë punuar gjykatës që nuk janë më të punësuar do t'u caktohen gjyqtarëve të tjerë me orar të përcaktuar elektronik në (AKMIS programin), në varësi të fushës së lëndëve dhe orarit të gjykatësve në këshillat.

Gjykatësit porotë që duhet të marrin pjesë në punën e këshillave civil dhe penal do të thirren nga ana e sekretarit teknik të kryetarit të gjyqit, me kërkesë me shkrim të gjykatësit referues, dhe për atë do të mbahet edhe evidencë e posaçme në përputhje me rregulloren gjyqësore.

SEANCAT E SEKSIONEVE

V.

Seancat e seksioneve do të mbahen sipas nevojës dhe do të zbatohen dispozitat e nenit 66 deri në nenin 75 të Rregullores gjyqësore.

Seancat e seksioneve do të marrin në konsideratë:

- çështjet ligjore të iniciuara nga gjykatësi, këshilltar,
- bashkëpunëtorët profesional, për të marrë përsipër zgjidhje ligjore të caktuara për çështje juridike kontestuese dhe për të harmonizuar praktikën gjyqësore;
- iniciimin e çështjeve juridike në fushën e përkatëse për mbledhjet e Gjykatave të Apelit në vend me qëllim të barazimit të praktikës gjyqësore;
- shqyrtimi i çështjeve ligjore nga gjykatat themelore në rrethinën e Gjykatës së Apelit në Gostivar;
- shqyrtimin i projektligjeve dhe propozimeve për ndryshimin e ligjeve;
- rishikimi i analizave, informacioneve dhe indikacioneve të paraqitura pranë institucioneve përkatëse;
- rishikimin e vendimeve të miratuara nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë për mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme, si dhe rishikimin e vendimeve të marra në bazë të pretendimeve të palëve lidhur me shkeljen e të drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme;
- rishikimin e punës së seksioneve gjatë vitit dhe rishikimin e raportit të seksionit në fund të vitit;
- shqyrtimin dhe miratimin e materialeve që do të jenë lëndë e shqyrtimit në një tryeze të rumbullakët të Gjykatave të Apelit; dhe
- gjëra të tjera që do të ndodhin gjatë punës që janë të nevojshme për të vënë në agjendën e seksionit.

Procesverbali mbahet nga sekretari i caktuar nga Kryetari i seksionit.

PROGRAMI I PUNËS TË BASHKËPUNËTORËVE BASHKËPUNËTORË GJYQËSOR

VI.

Gjatë vitit 2019 bashkëpunëtorët gjyqësor dhe punëtorët tjerë administrativ dhe teknik, do të punojnë sipas këtij programi:

1. Mirjana Petrovska, udhëheqëse e seksionit të informatikës;
2. Sevdali Sevdali Selmani, këshilltar inxhinjer informatik;
3. Redife Rexhepi Jusufi, bashkëpunëtor – përkthyes;
4. Besa Imeri, bashkëpunëtor i ri – përkthyes;
5. Sejhan Qeralla, bashkëpunëtor i ri, seksioni për punë materiale dhe financiare;
6. Mirçe Markovski, referent i pavarur, kontabilist;
7. Antonio Antonievski, referent i pavarur në seksionin e informatikës
8. Shpresa Osmani, referent i lartë gjyqësor, në sekretarinë e seksionit penal
9. Nail Beqiri, referent i ri gjyqësor, në sekretarinë e seksionit civil;
10. Lubomir Paunovski, referent i ri gjyqësor që udhëheq regjistrin e PRKZH;
11. Urime Bajrami, referent i lartë gjyqësor, në Arkivin e gjyqësorit
12. Silvana Jovanovska, referent gjyqësor – daktilograf;
13. Sevdije Shehi, referent gjyqësor – daktilograf;
14. Viktorija Deleska, referent gjyqësor – daktilograf;
15. Nexhbije Beqiri, referent gjyqësor – daktilograf;
16. Daniella Dimitrijevska, referent gjyqësor – daktilograf;
17. Berat Fejzuli, shofer;
18. Mimoza Bejni, pastruese.

Zbatimi i sistemit AKMIS në gjykatë kryhet përmes inxhinieres të informatikës Mirjana Petrovska dhe Sevdali Selmani, që heqin keqfunksionimet e rrjetit dhe kyçjen e stacioneve të punës në domain dhe krijojnë të njëjtat kapacitete ekzistuese të punës, që do të thotë servisimin e kompjuterëve të vjetër dhe heqjen e defekteve, si dhe përfshirjen e të gjitha stacioneve të punës në rrjet, bën shpërndarjen e postës elektronike e mail dhe çështje të tjera që lidhen me regjistrimin e të dhënave në gjyqësor.

Në sekretarinë e gjykatës, regjistrat elektronikë të përfshirë në sistemin AKMIS, dhe në përputhje me Rregulloren e Gjykatës, mirëmbahen dhe shpërndahen automatikisht nga nëpunësit e gjykatës në vijim,

- Shpresa Osmani, referent i lartë gjyqësor në sekretarinë e Seksionit penal, do ta udhëheq regjistrin “KZH”, “KZHM” “KSZH” dhe “KR” dhe do të bëjë shpërndarjen automatike të lëndëve nëpër gjykatës;

- Lubomir Paunovski, bashkëpunëtor i ri profesional në sekretarinë e Seksionit penal, do ta udhëheq regjistrin “PRKZH” dhe do të bëjë shpërndarjen automatike të lëndëve nëpër gjykatës; dhe

- Nail Beqiri, referent i ri gjyqësor, në sekretarinë e seksionit civil, do ta udhëheq regjistrin "GZH", "TSZH", "POZH" dhe "R" dhe do të bëjë shpërndarjen automatike të lëndëve nëpër gjykatës.

- Regjistrat "SU", "UPP", "SU-DOV", "SU-STR-DOV" dhe "SPI" do ti udhëheq deri në plotësimin e vendeve të punës Administrator gjyqësor, me vendim SU.nr.216/20 nga data 06.08.2020 është përcaktuar nëpunësi gjyqësor Sadulla Memedi.

Programi i lëndëve në Seksionin penal dhe civil do të kryhet me kompjuter siç përcaktohet në programin kompjuterik AKMIS, por përveç regjistrimit dhe mbajtjes së regjistrave, regjistrimet kompjuterike do të mbahen edhe për marrjen fizike dhe shpërndarjen e lëndëve.

Bashkëpunëtor gjyqësor Aleksandër Duroski me aktvendim SU nr. 0301-12/2011 më 16.01.2011 është përcaktuar person zyrtar për ndërmjetësim gjatë realizimit të drejtës për qasje të lirë deri tek informatat me karakter publik në këtë gjykatë, pra në pajtueshmëri me këtë aktvendim bashkëpunëtori gjyqësor është autorizuar ti udhëheq lëndët që regjistrohen në Regjistrin "SPI".

Bashkëpunëtor gjyqësor Sasho Nikolloski me vendim SU.nr.269/20 nga data 24.09.2020 është përcaktuar person zyrtar – oficer për mbrojtjen e të dhënave personale të punësuarve në Gjykatën e Apelit në Gostivar.

Bashkëpunëtori i ri gjyqësor Arjeta Iljazi me Vendimin SU. 341 / 2018 më 12.11.2018 është përcaktuar person zyrtar për zbatimin dhe mirëmbajtjen e ISO 9001: 2015 Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë dhe të udhëheq me - Ekipet e Përfaqësuesve të Menaxhimit të Cilësisë (TPRK) të cilët, përveç detyrave të tyre të rregullta, do të jenë përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve të procesit për zbatimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në përputhje me standardet ISO 9001: 2015.

Në këtë gjykatë të detyruar dhe përgjegjës për anonimizimin dhe publikimin e vendimeve të gjykatës në faqen e internetit të gjykatës dhe regjistrimin e tyre në sistemin AKMIS, janë referentët gjyqësor – daktilograf:

- Silvana Jovanovska;
- Sevdije Shehi;
- Nexhbije Beqiri;
- Viktorija Deleska; dhe
- Daniella Dimitrijevska.

Daktilografët bëjnë anonimizimin e vendimeve të gjykatësve në këshillat në të cilët janë caktuar të punojnë në muaj.

I. Vendimet e Kryetarit të gjykatës, është i detyruar dhe përgjegjës ti anonimizoj dhe shpall në faqen e internetit të gjykatës çdonjëri daktilograf, pa marrë parasysh ku është i caktuar në muaj.

1. Pas plotfuqishmërisë të vendimit brenda dy ditëve është e patjetërsueshme të bëhet anonimizimi dhe shpallja në faqen e internetit të gjykatës.

2. Në këtë gjykatë përgjegjës për përgatitjen e raportit në lidhje me vendimet gjyqësore të shpallura në faqen e internetit të gjykatës është:

- udheheqësi i seksionit të informatikës – inxhinier i informatikës Mirjana Petrovska,
- këshilltari gjyqësor – inxhinjer i informatikës Sevdali Selmani,
- referent i pavarur gjyqësor, Antonio Antonievski.

3. Pëllumbesha Seferi dhe Mirjana Petrovska kontrollojnë dhe mbikëqyrin vendimet e publikuara të gjykatës në faqen e internetit.

II. Kontrolli dhe mbikëqyrja e vendimeve anonime të sjellë nga gjykatësit të caktuar për të vepruar dhe të vendosin për ankesat e shkallës së dytë në Seksionin Penal.

1. Kontrolli dhe mbikëqyrja e vendimeve anonime të Këshillit Penal të sjella nga Kryetari i Gjykatës Bekim Mehmedi dhe gjykatësit Gjasim Gjasimovski dhe Shefajet Hajdari kryhet nga ana e udhëheqëses së administratës Pëllumbesha Seferi;

2. Kontrollin dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të Këshillit të parë të përbërë prej tre anëtarëve e kryejnë, edhe atë:

- këshilltari gjyqësor Vesna Iliq dhe bashkëpunëtori i ri Iljaz Ademi – kryejnë kontrollin dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të sjella nga gjykatësi Abdulbari Ramadani;
- këshilltari gjyqësor Vesna Iliq bën kontrollin dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të sjellë nga gjykatësit e Këshillit Penal prej pesë gjykatës.

3. Kontrollin dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të sjella në Këshillin e dytë Penal prej tre anëtarëve e kryejnë:

- këshilltari gjyqësor Mjaftime Neziri dhe Driton Osmani – bën kontrollin dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të sjella nga Gjasim Gjasimovski;
- këshilltari gjyqësor Mjaftime Neziri dhe Driton Osmani bëjnë kontrollin dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të sjella nga gjykatësi i cili me rotacion përcaktohet si anëtar i tretë në këshillin e dytë prej tre anëtarëve.

III. Kontrolli dhe mbikëqyrja e vendimeve anonime të sjellë nga gjykatës të caktuar për të vepruar dhe të vendosin për ankesat e shkallës së dytë në Seksionin Civil.

1. Kontrollin dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të daktilografëve, e bëjnë bashkëpunëtorët gjyqësor.

2. Kontrollin dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të këshillit të parë civil prej tre gjykatës e përbëjnë:

- këshilltari gjyqësor Leonora Jakupi– bën kontrollin dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të këshillit të parë civil prej tre anëtarëve të sjellë nga gjykatësit Velko Strashovski, dhe Ali Aliu;
- bashkëpunëtori i ri gjyqësor – Argjent Jakupi dhe Vjosa Ajdari ndihmon gjatë kontrollit dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të Këshillit të parë civil prej tre anëtarëve;

3. Kontrollin dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të këshillit të dytë civil prej tre gjykatës e përbëjnë:

- këshilltari gjyqësor Sasho Nikolloski – bën kontrollin dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të këshillit të dytë civil prej tre anëtarëve të sjellë nga gjykatësit Afrim Jakupi, dhe Zlatko Angjellkoski.

4. Kontrollin dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të këshillit të tretë civil prej tre gjykatës për konteste tregtare dhe të punës e përbëjnë:

- këshilltari gjyqësor Aleksandar Duroski – bën kontrollin dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të këshillit të tretë civil prej tre gjykatës për konteste tregtare dhe të punës të sjella nga gjykatësit Rafis Idrizi, Liljana Ickova dhe Izet Ismaili.

- këshilltari gjyqësor Arjeta Iljazi ndihmon gjatë kontrollit dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të këshillit të tretë civil prej tre gjykatës për konteste tregtare dhe të punës;

- bashkëpunëtori i ri gjyqësor – Nagip Bajrami ndihmon gjatë kontrollit dhe mbikëqyrjen e vendimeve anonime të këshillit të tretë civil prej tre gjykatës për konteste tregtare dhe të punës;

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

Me urdhër të Kryetarit të Gjykatës, duke pasur parasysh që vendet e lira të punës në bazë të Ligjit për Sistematizim nuk janë mbushur, stafi i kësaj Gjykate kryen edhe detyra të tjera të autorizuara nga Kryetari i Gjykatës.

Gjatë vitit, Kryetari i Gjykatës mund të bëjë ndryshime ose plotësim në këtë program, siç kërkohet, por edhe në varësi të vendeve të lira të punës.

Programi duhet t'i dorëzohet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit në Gostivar, regjistruar në sekretarinë e Gjykatës, Administratorit të Gjykatës, ndërsa punonjësit e tjerë të gjykatës duhet të njoftohen me orarin e punës duke nënshkruar kopjen që mbetet në Arkivin e Gjykatës.

Ky Program do të zbatohet nga 01 Janari 2021.

Kryetar i
Gjykatës Apelit Gostivar
Bekim Mehmedi

Kopje e Programit ti dorëzohet:

Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë Veriut;
Gjykatësve dhe administratës gjyqësore;
Arkivit të Gjykatës.

Kryetar i
Gjykatës Apelit Gostivar
Bekim Mehmedi

